



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**Keshilli i Ministrave**

**U R D H E R**

**Nr. 5, Date 18.01.2005**

**PER**

**KRIJIMIN E RRJETIT KOMPJUTERIK NE INSTITUCIONET E  
ADMINISTRATES PUBLIKE**

Ne mbeshtetje te pikes 3, te nenit 102, te Kushtetutes,

**U R D H E R O J:**

1. Te gjitha ministrите te krijojne, brenda dates 31 mars 2005, rrjetin e tyre te brendshem kompjuterik, ose te pershtasin rrjetin ekzistues.

2. Institucionet e tjera qendrore, ne varesi te Kryeministrit apo te ministrave, te krijojne ose te pershtasin rrjetin e tyre te brendshem kompjuterik, brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e ketij urdhri.
3. Rrjeti kompjuterik te plotesoje parametrat teknike sipas Aneksit 1, qe i bashkelidhet ketij urdhri dhe eshte pjese perberese e tij.
4. Ministrite dhe institucionet e tjera qendrore te raportojne ne Departamentin e Administrates Publike, prane Keshillit te Ministrave, per krijimin, brenda afateve te parashikuara ne pikat 1 dhe 2, te ketij urdhri, te rrjetit kompjuterik.
5. Ngarkohen ministrite dhe institucionet qendrore per zbatimin e ketij urdhri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**K R Y E M I N I S T R I**

**FATOS NANO**

## **Karakteristikat teknike te rrjeteve te brendshem kompjuterike**

### **A. Kabllimi:**

- Kabllimi duhet te jete CAT 5 ose CAT 6 (UTP ose STP ne varesi te interferencave).
- Duhet te respektohen distancat qe te lejon ky lloj kabllimi;
- Kabllimi duhet te respektoje standartin Fast Ethernet 100 Base T (IEEE802.3u) ose GigaBit 1000-MB Ethernet 1000 Base-T (IEEE 802.3z).

### **B. Paisjet perberese te rrjetit:**

- Pajisjet duhet te jene Layer-2 switch ose HUB 100/1000 MB bazuar ne standarte Etherneti;
- Institucioni duhet te kete servera (minimalisht nje te tille) i/te cili(et) duhet te perdoret per administrimin e perdoruesve dhe te postes elektronike;
- Institucioni duhet te paiset me UPS, Stabilizator ose Inverter te cilet te mbajne minimalisht paisjet kryesore (Routera, Servera, Switch dhe hub).

### **C. Topologjia:**

- Rrjeti kompjuterik duhet te kete nje topologji ne forme ylli, e cila bazohet mbi switch-e dhe hub-e qe do bejne te mundur centralizimin e kabllimeve.

### **Ç. Mjedisi i ruajtjes se paisjeve:**

- Paisjet e IT si servera, hube, switche dhe routera rekomandohen te jene te montuara ne rack.
- Pika kryesore e centralizimit te rrjetit dhe vendosja e paisjeve duhet te jete nje mjedis i veçante dhe i dedikuar vetem per kete qellim, me temperature konstante dhe energji elektrike te stabilizuar dhe te pandërprere.
- Pikat e centralizimit te kabllimeve neper kate duhet e jene te montuara ne rack, te siguruara me çeles dhe ne mjedise te sigurta.

### **D. Protokollet e Komunikimit**

Protokollet e komunikimit ne rrjet duhet te jene te bazuar ne paketen TCP/IP.

### **DH. Administrimi:**

- Perdoruesit e rrjetit duhet te administrohen ne menyre te centralizuar (nje server qe luan rolin e Domain Controller). Kjo duhet te lejoje administrimin e te gjitha paisjeve kompjuterike (kompjuterat, printerat).
- Posta elektronike duhet te administrohet nga nje Mail-server i institucionit.
- Administrim i centralizuar i antivirusit dhe perdorimit te internet-it (proxy, firewall).
- Administrimi i faqes se internetit dhe web server-it.
- Back-up te paisjeve kryesore te operimit dhe informacionit te nevojshem